

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PERGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

AGJENCISË PËR PRONËSINË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) dhe Agjencia për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës (API), në vijim të referuara si "Zyrat";

DUKE KONSIDERUAR rëndësinë e pronësisë industriale për zhvillimin e ekonomisë, promovimin e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë,

DUKE NJOHUR nevojën për të promovuar dhe përmirësuar inovacionin dhe për të forcuar sistemet kombëtare të pronësisë industriale, me qëllim garantimin e administritimit të duhur, mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të pronësisë industriale,

DUKE KUPTUAR nevojën për bashkëpunim më të gjerë bilateral ndërmjet zyrave për të forcuar sistemet e pronësisë industriale ekzistuese duke krijuar një mekanizëm për të pasur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira dhe për të ndërmarrë së bashku trajnime dhe aktivitete të tjera bashkëpunuese, si dhe për të kontribuar në përhapjen e tij ne rajon,

DUKE DËSHIRUAR nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës me qëllim promovimin e shkëmbimeve ekonomike dhe teknologjike,

Bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në vijim i referuar si "Memorandum" është themelimi i një mekanizmi fleksibël dhe me fushë të gjerë për udhëzimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Zyrave në fushën e pronësisë industriale, në përputhje me përgjegjësitë e të dy zyrave në këtë fushë.

Zrat bien dakord që të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e sistemeve të tyre përkatëse të pronësisë industriale.

Neni 2 **Fushat e Bashkëpunimit**

Bashkëpunimi ndërmjet zyrave do të mbulojë kryesisht fushat e mëposhtme:

1. Shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin në fushën e pronësisë industriale dhe reflektimet për përmirësimin e tij;
2. Shkëmbimin e publikimeve të ndryshme në lidhje me fushën e pronësisë industriale;
3. Bashkëpunim në programet e trajnimit lidhur me pronësinë industriale;
4. Bashkëpunim në fushën e përpunimit të informacionit të patentave dhe shërbimeve për publikun;
5. Organizimin e seminareve, workshop-eve dhe tryezave të rrumbullakëta të përbashkëta, rrëth rolit të PI-së në inovacionin dhe rritjen ekonomike, si dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik në lidhje me PI-në;
6. Shkëmbimin e informacionit jo-konfidencial të lidhur me PI-në dhe praktikat më të mira;
7. Bashkëpunim në ngritjen e kapaciteteve në ekzaminimin dhe dhënien e pronësisë industriale nga zyrat;
8. Drejtime të tjera të ardhshme të bashkëpunimit lidhur me PI-në, siç është rënë dakord reciprokisht nga zyrat;
9. Zbatimi i sistemeve të kompjuterizuara të zyrave, në hartimin e raporteve të kërkimit, procedurat e ekzaminimit, etj;
10. Rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e pronësisë industriale për aplikantët Kosovarë në Shqipëri dhe për aplikantët shqiptarë në Kosovë, si dhe promovimin e saj;
11. Politikën e trajnimit të stafit sipas programeve të specializimit ose seminareve;
12. Trajnimin e stafit të zyrave;
13. Bashkëpunim ndërmjet nivelit të njëjtë të sektorëve dhe drejtorive të zyrave, me qëllim të zbatimit të vendimeve dhe marrëveshjeve të menaxhuara nga Organizata e Ndërkombëtare, përkatësisht WIPO dhe EPO;
14. Hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta në fushën e PI-së.

Neni 3 **Mënyra e Bashkëpunimit**

Bashkëpunimi i zyrave do të përfshijë fushat e mësipërme dhe do të koordinohet edhe nga programet e tjera të bashkëpunimit në fushën e pronësisë intelektuale, që përfshijnë Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), Organizatën Evropiane të Patentave (EPO) dhe Zyrën e Bashkimit European të Pronësisë Intelektuale (EUIPO) sipas marrëveshjeve të lidhura nga zyrat.

Neni 4 **Zbatimi i Memorandumit**

Ngarkohet një Komitet Monitorimi i përbërë nga zyrtarë të të dy zyrave. Ky komitet është themeluar me qëllim monitorimin dhe vlerësimin për zbatimin e këtij memorandumit. Data, vendi dhe agjenda e mbledhjeve të Komitetit të Monitorimit përcaktohen bashkërisht nga zyrat.

Zyrat angazhohen që të sigurojnë përpjekjet e tyre më të mira për të garantuar zbatimin e suksesshëm të memorandumit dhe aktivitetet për të cilat bien dakord bashkërisht, në programet e punës dhe fushat e bashkëpunimit.

Neni 5 Pikat e Kontaktit

Zyrat do të caktojnë personat si koordinatorë për të gjithë çështjet në lidhje me këtë memorandum.

Neni 6 Shpenzimet

Përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe, secila zyrë do të paguajë shpenzimet e veta, veçanërisht shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për zyrtarët dhe ekspertët që do qëndrojnë në zyrën ose institucionin e zyrës tjetër.

Neni 7 Takimet e punës

Zyrat do të zhvillojnë takime pune në mënyrë të alternuar në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës për të diskutuar zhvillimin e bashkëpunimit. Zyrat gjithashtu do të bien më tej dakord mbi periudhat dhe datat përkatëse. Rezultatet e takimeve do të përmblidhen në protokollet e diskutimeve.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore me marrëveshje të përbashkët ndërmjet zyrave.

Neni 9 Dispozita përfundimtare

Ky memorandum do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe do të ketë një kohëzgjatje prej pesë vitesh (5) të ripërtëritshme për periudha shtesë me kohëzgjatje të njëjtë objekt i marrëveshjes së ndërsjellë të zyrave.

Ky memorandum mund të ndryshohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet zyrave, formalizuar në një shkëmbim dokumentesh duke specifikuar datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Përfundimi parë kohë i këtij memorandumit nuk do të ndikojë në përbushjen e ndonjë bashkëpunimi të pranuar sipas programeve të mirruara, të pures, përvçesë kur bashkërisht çshtë rënë dakord ndryshe nga zyrat.

Nënshtuar në Peje, më 26.11.2018, në gjithë shqipë, serbe
të gjithë tekstet njëlloj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, tekste të
gjuhën shqipe do të përvëlojë.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë i
Republikës së Shqipërisë

Arben AHMETI

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë i
Republikës së Kosovës

Endrit SHALA